VENDIM
Nr.84, datë 13.9.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani